



СЛУЖБЕНИ ГЛАСНИК ОПШТИНЕ БУЈАНОВАЦ

GAZETA ZYRTARE E KOMUNËS SË BUJANOCIT

-VITI III. -NUMËR 6.	- BUJANOC 24.04.2015 E premte 24.04.2015	Botohet sipas nevojës – Çmimi 500 din.
-------------------------	--	---

AKTET E KOMUNËS

PRESHEVË

a osnovu **68** 15. 2.
(„
“, 26/2008)
16.04.2015

Në mbështetje të nenit 15. Paragrafi 2.të Statutit të Komunës së Preshevës (“Fl. zyrtare e Rrethit të Pčinjës, numër 26/2008) Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me datë 16.04.2015, nxjerr këtë:

AKTVENDIM PËR DHËNIN E PËLQIMIT NË STATUTIN E BIBLIOTEKËS “MEHMET JUSUFI “ PRESHEVË

I.
„
“, 26/2015 06.03.2015.

Jepet pëlqimi në Statutin e Bibliotekës “Mehmet Jusufi” Preshevë, të cilën e ka sjellur Këshilli drejtuesi shtëpisë së Kulturës “ A. Krashnica “ Preshevë me nr.26/2015 të datës 06.03.2015.

II
„
Statuti i Bibliotekës “Mehmet Jusufi” Preshevë do të jetë pjesë përbërëse e këtij Aktvednimi.

III.

Ky aktvendim të shpallet në “Gazetën zyrtare e komunës së Bujanocit”

KUVENDI I KOMUNËS PRESHEVË

I , Nr. 110-25
, 20.04.2015

P r e s h e v ë

, Kryetar,
.Dr. Ramiz Latifi

69

44 1 1,
(. . 72/09), 17, 1

(. . 72/09, 55/14), 1 1.

4

06.03.2015

630-1/08,

„

“

1
 (: ”) “ ,
 , :
 8
 2 - 92511- (:
 ,)
 .630-1/08,
 25.11.2008 .
 9
 5-253-00.
 3 10
 : „ “
 4
 ” “
 ” “
 5
 6
 3 , :
 ” “ 11
 , 6,5 x 3 ,
 : 20 , “
 7
 12
 30

16

5

13

17

18

14

15

).

;

;

”

“

(552)2,

”

10.05.2014,

19 .34/14.

,

:

23

,

24

.

20

:

.

.

1

,

25

:

1.

2.

3.

,

26

,

21 5 : (2)

, (1)

:

,

(2)

,

,

,

,

,

,

(15) ,

.

22

,

4

(2) .

,

,

30%

32

(2)

(4)

27

33

28

34

4

60

29

(30)

(15)

30

35

31

30%

1.
2.

()

3.

36

37

38

39

40

41

42

43

51

44

. 45. 01.12.2010 .

52

45

y

69

46

Në bazë të Nenit 44 paragrafi 1 pika 1. Të ligjit mbi kulturën (FL.zyrtare e RS. Nr.72/09, Nenit 17, paragrafi 1 të ligjit mbi këshillat nacionale të pakicave nacionale (Fl. Zyrtare e RS. Nr.72/09 dhe 55/14), Nenit 1 paragrafi 1,Pika 4. E vendimit të Këshillit nacional të pakicës nacionale shqiptare, mbi përcaktimin e institucioneve publike me rëndësi të vacant për ruatjen, avansimin dhe zhvillimin e veçorive të indentitetit nacional të pakicës nacionale shqiptare,(Fl.zyrtare e Rs.nr 118/12), dhe Vendimit të Kuvendit komunal të Preshevës nr. 630-1/08, mbi themelimin e Bibliotekës “Mehmet Jusufi”, Këshilli Drejtues i Bibliotekës “Mehmet Jusufi” në Preshevë, në mbledhjen e vetë të mbajtur më 06.03.2015 harmonizon këtë:

47

S T A T U T I I BIBLIOTEKËS “MEHMET JUSUF” NË PRESHEVË

DISPOZITAT BAZË

Neni 1

48

Biblioteka “ Mehmet Jusufi” në Preshevë (në tekstin vijues Biblioteka) është institucion me interes të përgjithshëm në lëmin e kulturës e cila kryen punët në pajtim me Ligjin mbi veprimtarinë bibliotekare, me Statut dhe me akte tjera juridike.

Veprimtaria e Bibliotekës është publike.

49

POZITA JURIDIKE E BIBLIOTEKËS

Neni 2

50

Biblioteka ka cilësinë e personit juridik e cila kryen punët apo veprimtarin në fushën e Kulturës.

Biblioteka është themeluar me Vendim të Kuvendit Komunal në Preshevë me Nr.630-

1/08, më 25.11.2008. Dhe është e regjistruar në Regjistrin e Gjykatës ekonomike në Leskoc,numri I mbështjellsit të regjistrit është 5-253-00.

Neni 3

Emërtimi i bibliotekës është Biblioteka “Mehmet Jusufi” në Preshevë. Biblioteka mund të ndryshon emërtimin vetëm me pëlqimin e marrur nga themeluesi.

Neni 4

Selia e Bibliotekës është në objektin e Shtëpisë së Kulturës “ Abdulla Krashnica” në Preshevë, nga ana e rrugës “Mare Llonçar”.

Neni 5

Biblioteka ka xhirollogarinë e vetë.

Neni 6

Biblioteka ka vulën e rumbullakët dhe vulën katrore.

Vula e bibliotekës është në formë të rumbullakët, me diametër 3 cm, në vulë është teksti në qark: Biblioteka “Mehmet Jusufi” Preshevë. Në mes është stilizuar libri i hapur, symbol i Bibliotekës.

Vula katrore e Bibliotekës është në formë këndrejt, në madhësi 6.5 x 3cm me mbishkrimin në gomë: BIBLIOTEKA “MEHMET JUSUFI” nr. _____, _____ 20 _____, Preshevë.

Teksti i vulës së rumbullakët dhe vulës katrore është i shkruar në dy gjuhë atë shqipe dhe serbe.

Biblioteka mund të ketë edhe vula të tjera për libra dhe shtyp.

PËRFAQËSIMI DHE PREZANTIMI

Neni 7

Bibliotekën si Institucion e përfaqëson dhe e prezanton Drejtori.

Drejtorin, në mungesë prej 30 ditësh e zëvendëson punëtori të cilin e autorizon Drejtori. Për mungesë më të gjatë këshilli drejues cakton se kush do ta zëvendëson Drejtorin. Punëtori i cili e zëvendëson Drejtorin ka të gjitha kopetencat e Drejtorit.

VEPRIMTARIA DHE ORGANIZIMI I MBRENDSHËM

VEPRIMTARIA:

Neni 8

Biblioteka kryen veprimtarinë si vijon:
-92511- të Bibliotekës (veprimtaria bibliotekare).

Për ndryshimin e veprimtarisë së Bibliotekës është i duhur pëlqimi i themeluesit.

Neni 9

Biblioteka realizon veprimtarin e vetë në kuadër të sistemit të përbashkët bibliotekar-informativ në Republikë.

Neni 10

Biblioteka kryen veprimtarinë e saj në kushte dhe mënyrë të drejtë, kualitative me të cilën sigurohen kushtet e nevojave të shfrytëzuesve dhe kryerjen e detyrave të përcaktuara me Ligj dhe Statutin e saj.

Biblioteka me aktin e përgjithshëm rregullon kushtet dhe mënyrën e ofrimit të shërbimeve dhe shfrytëzimin e tyre, si dhe shfrytëzimin e materialit të bibliotekës si kryerje e shërbimeve të veçanta.

Materiali i Bibliotekës i ofrohet shfrytëzuesve nën kushte të barabarta, nëse me Ligj nuk është e rregulluar ndryshe.

Biblioteka i vë në dispozicion shfrytëzuesve të vet hapsirën e saj të caktuar dhe burimet informative çdo ditë pune gjatë orarit të rregullt të punës.

Neni 11

Biblioteka kryen veprimtarinë, në kushtet dhe mënyrën e përcaktuar me ligj, në pajtim me qëllimet për ç’arësye është themeluar.

Shfrytëzimi i librave dhe materialit tjetër të bibliotekës bëhet pa kompenzim. Anëtarët e Bibliotekës paguajnë anëtarësi vjetore shumë e të cilit e përcakton Këshilli Drejtues i Bibliotekës.

Shërbimet tjera për anëtarët, si dhe shërbimet ndaj personave tjerë juridik dhe fizik të Bibliotekës kryhen me kompenzim, të cilat në pajtim me programin e punës së Bibliotekës i përcakton Drejtori.

ORGANIZIMI I MBRENDSHËM:

Neni 12

Veprimtaria e Bibliotekës kryhet në selinë e saj dhe në nëndegë nëpër vendbanime të cilat e kanë statusin e njërive organizative të Bibliotekës.

Organizimi i mbrendshëm i Bibliotekës përcaktohet varësisht nga ndërlikueshmëria, vëllimi dhe natyra e punëve dhe detyrave të cilat i kryen, në mënyrë me të cilën veçanërisht sigurohet:

- realizimi me kohë i funksioneve të përcaktuara me ligj dhe plotësimi i interesave të shfrytëzuesve,
- udhëheqja dhe realizimi i sukseshëm i përgjegjësive në punë,
- ligjshmëria, profesionaliteti, efikasiteti dhe racionaliteti në kryerjen e detyrave dhe punëve
- realizimi i sukseshëm i bashkëpunimit me bibliotekat tjera, institucionet kulturore, shkencore dhe arsimore.

Neni 13

Njësitë oragizative mund të formohen si nëndegë. Mbrenda bibliotekës mund të organizohen shërbimet, seksionet, grupet, referatat dhe format tjera të punës.

Në kuadër të Bibliotekës mund të formohen edhe këto Komisione:

- a) Komisioni për prokurim dhe hartim,
- b) Komisioni për punë me lexuesit e rritur,
- c) Komisioni për punë me fëmijë,
- d) Komisioni profesional.

Biblioteka kryen veprimtarin e vetë edhe në nëndegët:

- në bashkësin lokale në Miratoc,
- në bashkësin lokale në Leran,
- në bashkësin lokale në Rahovicë.

Neni 14

Me rregulloren mbi oragnizimin e mbrendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës më për së afërmi përcaktohet fushëveprimi i punës së bibliotekës në qendër dhe njësi organizative, mënyra e kryerjes së punëve dhe detyrave, mënyra e udhëheqjes, programimi dhe realizimi i obligimeve, vendet e punës, llojit dhe numërit të njërive organizative.

Këshilli komunal jep pëlqim në rregulloren mbi organizimin e brenshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

PLANIFIKIMI DHE MJETET

Planifikimi:

Neni 15

Planet dhe programet e punës dhe zhvillimit të Bibliotekës hartohen në pajtim me qëllimet dhe detyrat për të cilat është themeluar, të përcaktuara me Ligj, kërkesat e Kuvendit të komunës, nevojat e shfrytëzuesve si dhe zhvillimit ekonomik, kulturor dhe arsimor të komunës.

Bazë e programit të punës së Bibliotekës janë detyrat dhe obligimet të përcaktuara me Ligj apo me dispozitat dhe obligimet tjera ndaj organit kompetent dhe Bibliotekës popullore të Sërbisë.

Neni 16

Biblioteka nxjerr programin vjetor dhe planin financiar të punës për një vit kalendarik dhe planin dhe programin afatmesëm të punës dhe zhvillimit për periudhë 5 vjeçare.

Në pajtim me Programin vjetor të punës hartohen, sipas nevojës edhe planet operative me të cilat më për së afërmi përcaktohen detyrat nga programi i punës, afatet për realizimin e qëllimeve dhe detyrave nga programi vjetor i punës, mënyra e kryerjes dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre.

Neni 17

Programin vjetor të punës dhe planin e zhvillimit të Bibliotekës, me propozim të Drejtorit, e nxjerr Këshilli Drejtues në afat të përcaktuar me Ligj.

Për realizimin e programit të punës dhe planit të zhvillimit përgjegjës është Drejtori.

Këshilli drejtues i Bibliotekës shqyrton realizimin e programit vjetor të punës, planit të zhvillimit dhe ndërmerr masa për realizimin e tyre në bazë të raportit të Drejtorit të Bibliotekës.

Neni 18

Me programin vjetor të punës përcaktohen përmbajtjet të cilat dalin nga qëllimet e përcaktuara me Ligj mbi veprimtarinë Bibliotekës, e veçmas paraqiten:

- lloji, vëllimi, përmbajtja, mënyra dhe koha e realizimit të punëve dhe detyrave,
- aktivitetet programore të cilat do të kryhen në bashkëpunimin në mes veti me institucionet tjera si dhe programet tjera të veçanta (ekspozitat, takimet letrare, projektet e veçanta, botimi i revistave dhe publikimeve tjera, ndihma profesionale Bibliotekave, mbrojtja e materialit të Bibliotekës etj.),
- numri i tërësishëm i punëtorëve për realizimin e programit të punës dhe struktura e tyre sipas shkallës së kualifikimit profesional,
- kushtet materiale, tekniko hapsinore, organizative dhe kushtet tjera të duhura për realizimin e programit të miratuar të punës, si dhe kushtet për modernizimin e punës me qëllim të ngritjes së kualitetit dhe efikasitetit,
- aktivitetet programore gjegjësisht përmbajtjet dhe punët të cilat do të realizohen për Institucionet tjera, të tregut ose sipas bazës tjetër juridike për punën e lejuar,
- mjetet e duhura për realizimin e programit të punës dhe aktivitetëve (plani i rrogave të punëtorëve, shpenzimeve materiale, investimeve, mirëmbajtjes investive, mjeteve të duhura për blerjen e librave, periodike dhe materialit tjetër të bibliotekës si dhe dedikimet tjera të veçanta),
- aftësimin profesional dhe pjesmarrja në semianre të caktuara që kanë të bëjnë me lëmin e bibliotekës.

Neni 19

Punët, gjegjësisht detyrat dhe obligimet në programin e punës së Bibliotekës paraqiten në mënyrë:

- që të parasheh numrin e duhur të punëtorëve dhe shumën e mjeteve të domosdoshme për realizimin e programit të punës dhe programeve të veçanta të aktivitetëve, si dhe

efektet që arrihen me realizimin e programit të punës.

Neni 20

Programi i punës së Bibliotekës mbështetet edhe në -- Normativat dhe standardet për kryerjen e veprimtarisë, si dhe, -- Normativat e punës të përcaktuara dhe verifikuara në mënyrën profesionale, për paraqitjen e shpenzimeve materiale.

Gjatë përcaktimit të normativave dhe standardeve nga al.1 i këtij neni, fillohet nga shfrytëzimi optimal i orarit të plotë të punës, të qëllimeve të përcaktuara me Ligj, vëllimit të punës të përcaktuar me programin e punës.

Normativat dhe standardet me kohë hulumtohen dhe harmonizohen gjatë çdo modernizimi dhe avansimi të procesit të punës.

Normativat dhe standardet i nxjerr Këshilli drejtues në pajtim me dispozitat të cilat i nxjerr Ministria e kulturës së Serbisë, Bibliotekës popullore të Serbisë, Kuvendit të komunës Preshevë, dhe Këshilli Nacional Shqiptarë.

Neni 21

Mjetet për punën e Bibliotekës sigurohen nga:

- buxheti i komunës,
- punët dhe programet e caktuara nga buxheti i Republikës,
- drejtëpërsëdrejti nga shfrytëzuesit, përmes anëtarësisë,
- shitje e prodhimeve dhe shërbimeve në treg,
- donatorët, pasuria e dhënë me testament, dhuratë, dhënje me testament,
- burimet tjera në pajtim me Ligjin.

Mjetet e Bibliotekës shfrytëzohen sipas dedikimit të tyre në pajtim me Ligjin.

Biblioteka përgjigjet për obligimet me mjetet me të cilat disponon.

Neni 22

Pasurinë e Bibliotekës e përbejnë gjësendet, të drejtat dhe të hollat.

Biblioteka është e obliguar të udhëheqë librat e punës dhe t'i mbyllë në mënyrë periodike duke përpiluar në bazë të tyre llogaritë periodike dhe përfundimtare.

Biblioteka ka marrvëshje të veçantë me shtëpinë e Kulturës “Abdualla Krashnica” në Preshevë e cila rregullon shfrytëzimin e hapësirës punuese në katin e parë, apo në katror prej gjithsej (552)m², hyrja e së cilës është nga ana e rrugës Mare Lonçar, në afat të pacaktuar përmes një Kontrate të bërë me 10.05.2014, me nr. Pr. 34/14.

Neni 23

Biblioteka obligohet që pasurin e saj të e sigurojë në shtëpinë për sigurimin e pasurisë.

Neni 24

Materiali i Bibliotekës shfrytëzohet në mënyrë dhe kushte të përcaktuara me Ligj dhe me akte të përgjithshme.

Materiali i Bibliotekës nuk guxon të dëmtohet ose shkatërrohet.

Në rast të dëmtimit ose shkatërrimit të materialit të Bibliotekës shfrytëzuesi është i obliguar ta kompenzon dëmin.

ORGANET UDHËHEQËSE TË BIBLIOTEKËS

Neni 25

Organet udhëheqëse të Bibliotekës janë:

1. Këshilli Drejtues
2. Këshilli Mbykqyrës
3. Drejtori.

Këshilli Drejtues:

Neni 26

Këshilli drejtues është organ udhëheqës i Bibliotekës.

Këshillin drejtues të Bibliotekës e përbëjnë 5 anëtarë: dhe atë dy (2) anëtarë i cakton themeluesi, një (1) anëtarë e cakton këshilli nacional i pakicës nacionale shqiptare, dhe dy (2) anëtarë caktohen nga përbërja e punëtorëve të Bibliotekës, në pajtim me ligjin.

Në listën e propozuar të anëtarëve të Këshillit Drejtues nga radhët e themeluesit dhe të institucionit jep mendim këshilli nacional i pakicës nacionale shqiptare.

Afati i dhënjes së mendimit për anëtarët e propozuar të këshillit Drejtues nga ana Këshillit nacional të pakicës nacionale shqiptare është 15 ditë, nëse mendimi nuk jepet mbrenda këtij afati atëherë konsiderohet se mendimi është dhënë.

Këshillin drejtues të Bibliotekës dhe kryetarin e Këshillit drejtues e emëron dhe e shkarkon themeluesi.

Anëtarët e Këshillit Drejtues zgjidhen me mandatë 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje më së shumti dy (2) here.

Në rast të dorëheqjes apo shkarkimit të ndonjë anëtari të Këshillit Drejtues, rizgjidhet anëtari i ri me procedurë të njejtë sikur anëtarët tjerë të Këshillit Drejtues.

Përbërja e Këshillit Drejtues duhet të jetë më së paku 30% të gjinisë më pakë të përfaqësuar.

Neni 27

Këshilli drejtues kryen këto punë:

- nxjerr Statutin e Bibliotekës,
- vendos mbi punën e Institucionit,
- miraton raportin mbi punën dhe llogarinë përfundimtare,
- nxjerr programin e punës së Bibliotekës në propozim të Drejtorit,

- vendos mbi shfrytëzimin e mjeteve në pajtim me Ligjin,
- nxjerr vendimin mbi ankesat e punëtorëve,
- kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Ligj, me aktin mbi themelimin dhe me Statut,
- shpallë konkursin për drejtor dhe e propozon kandidatin e caktuar,
- nxjerr edhe akte tjera të përgjithshme.

Neni 28

Këshilli drejtues punon në mbledhje.

Mbledhjet e Këshillit Drejtues i konvokon kryetari dhe udhëheq me punën e tyre, e në rast të mungesës të kryetarit të k.d. mbledhjet i udhëheq , anëtari të cilin ai e autorizon.

Në rast të paraqitjes së çfarëdo pengese në udhëheqjen e institucionit nga ana e organit inokos (drejtorit), atëherë Këshilli Drejtues udhëheq me institucionin të cilin e kryeson kryetari i Këshillit Drejtues deri në emërimin e drejtorit.

Këshilli drejtues vendos me shumicë votash nga numëri i përgjithshëm i anëtarëve të vetë.

Neni 29

Mbi mënyrën e punës në mbledhje, udhëheqjen e procesverbalit dhe çështjeve tjera të rëndësishme Këshilli drejtues nxjerr Rregulloren mbi punën e saj.

Anëtarët e këshillit Drejtues kanë të drejtë në kompezim për punën e tyre, shuma e të cilës përcaktohet me vendim të veçantë të themeluesit në pajtim me ligjin.

Këshilli Mbikqyrës:

Neni 30

Këshillin mbikqyrës e emëron dhe e shkarkon themeluesi.

Këshilli mbikqyrës ka tre anëtarë dhe atë dy (2) anëtarë i cakton themeluesi dhe një (1) anëtarë nga përbërja e punëtorëve të bibliotekës.

Këshilli mbikqyrës ka kryetarin, të cilin gjithashtu e emëron themeluesi.

Neni 31

Puna e Këshillit mbikqyrës më për së afërmi përcaktohet me Rregulloren mbi punën.

Përbërja e Këshillit mbikqyrës duhet të jetë më së paku 30% të gjinisë më pakë të përfaqësuar.

Neni 32

Anëtarët e Këshillit Mbykqyrës zgjidhen me mandatë 4 vjeçar.

Anëtarët e Këshillit Mbykqyrës kanë të drejtë të emërohen më së shumti (2) herë nga katër (4) vite.

Në rast të dorëheqjes apo shkarkimit të ndonjë anëtari prej Këshillit Mbykqyrës, rizgjidhet anëtari i ri me procedure të njejtë sikur anëtarët tjerë të Këshillit Mbykqyrës.

Drejtori

Neni 33

Drejtori udhëheq me Bibliotekën, organizon procesin e punës dhe udhëheq punën e Bibliotekës, në mënyrë të pavarur nxjerr Vendime në pajtim me Ligjin, përfaqëson Bibliotekën dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e punës së Bibliotekës.

Drejtori ka pozitën e drejtorit të institucionit me të drejtat dhe obligimet e drejtorit të ndërmarrjes, si udhëheqës inokos i organit.

Drejtori për punën e vetë i përgjigjet Këshillit drejtues, dhe Themeluesit.

Neni 34

Drejtori I Bibliotekës „Mehmet Jusufi“ emërohet në bazë të konkursit publik të shpallur nga Këshilli Drejtues, në mandat katër (4) vjeçar dhe mund të rizgjidhet përsëri.

Konkursin publik e shpall dhe e zbaton Këshilli Drejtues i këtij Institucioni.

Konkursi publik shpallet 60 ditë para skadimit të mandatit të drejtorit.

Këshilli Drejtues është i obliguar që në afat prej 30 ditëve, nga dita e mbylljes së konkursit publik të bëjë zgjedhjen e kandidatit dhe propozimin të ia dërgoj themeluesit.

Drejtorin e Bibliotekës „Mehmet Jusufi“ e emëron themeluesi në propozim të Këshillit Drejtues, pas dhënjes së mendimit nga ana e këshillit nacional të pakicës nacionale shqiptare.

Afati i dhënjes së mendimit për drejtor nga ana e këshillit nacional të pakicës nacionale shqiptare është (15) ditë, nëse mendimi nuk jepet mbrenda këtij afati atëherë konsiderohet se mendimi është dhënë.

Për drejtor mund të emërohet personi që ka kualifikim superior, shkallën (VII), Së paku tri vjet përvojë pune në fushën e kulturës, dhe të ketë aftësi organizative.

Neni 35

Detyra e Drejtorit të Bibliotekës “Mehmet Jusufi” ndërpritet me përfundimin e mandatit.

Themeluesi mundë të shkarkoj drejtorin para përfundimit të mandatit:

- 1.Me kërkesë personale (dorëheqje),
- 2.Nëse kryen punën në kundërshtim me ligjin,
- 3.si dhe në raste tjera të parapara me ligj dhe statut.

Neni 36

Mbi realizimin e obligimeve në udhëheqje me Bibliotekën drejtori:

- përfaqëson dhe prezenton Bibliotekën
- nxjerr aktet e përgjithshme në pajtim me Ligjin,
- organizon dhe udhëheq procesin e punës,

- udhëheq dhe përgjigjet për punën e Bibliotekës,
- siguron ligjshmërinë e punës,
- realizon Vendimet e Këshillit drejtues,
- udhëheq me organet profesionale,
- propozon programin e punës, planin e zhvillimit dhe bazat e politikës së punës dhe ndërmerre masa për zbatimin e tyre,
- nxjerr vendime të veçanta mbi realizimin dhe shfrytëzimin e mjeteve sipas dedikimit të përcaktuar me planin financiar,
- vendos mbi të drejtat e veçanta, obligimet dhe përgjegjësitë e punëtorëve në pajtim me Ligjin dhe kontratën kolektive,
- paraqet raportin mbi punën dhe rezultatet e punës së Bibliotekës dhe llogarinë periodike dhe përfundimtare,
- formon komisione dhe trupa tjerë ndihmës,
- kryen edhe punë tjera të parapara me Ligj, me kontratën kolektive dhe me Statut.

Neni 37

Drejtori mund të formon Këshillin profesional si trup të vetin këshilldhënës të punës, të shqyrtimit të çështjeve nga puna e Bibliotekës dhe të realizimit të programit të punës.

Me Vendimin mbi formimin e Këshillit profesional përcaktohet numri, përbërja dhe mënyra e punës së Këshillit.

Mbi çështjen që është në rend dite Këshilli jep mendimin që nuk e obligon drejtorin me rastin e vendosjes, gjegjësisht përcaktimin e propozimit.

MBROJTJA DHE SIGURIA CIVILE

Neni 38

Të punësuarit në Bibliotekë realizojnë mbrojtjen dhe sigurinë civile me organizimin e punëve dhe detyrave të sigurisë civile, me sigurimin e mjeteve, nxjerrjen e planeve të sigurisë civile, ndërmarrjen e masave dhe aktivitetëve në realizimin e planeve dhe programeve të sigurisë civile.

Planet dhe programet e aktivitetit të mbrojtjes dhe sigurisë civile i përcakton dhe i nxjerr Këshilli drejtues.

Drejtori është organizator i punëve në realizimin e planeve dhe programeve të mbrojtjes dhe sigurisë civile dhe drejtpërdrejtë përgjegjës për zbatimin e tyre.

Neni 39

Realizimi i mbrojtjes dhe sigurisë civile konsiston në mënyrën e nxjerrjes së planeve dhe programeve të punës, sigurimi i mjeteve, si dhe çështjet tjera të realizimit të sigurisë civile, më për së afërmi rregullohet në veçanti në aktin e përgjithshëm.

MËNYRA E REALIZIMIT TË BASHKËPUNIMIT DHE KUSHTET PËR PUNËN E SINDIKATËS

Neni 40

Drejtori i Bibliotekës është i obliguar që sindikatës t'i siguroj kushtet për punë në pajtim me rolin dhe detyrat e saja dhe ate:

- që idetë, iniciativat, kërkesat dhe propozimet e sindikatës shqyrtohen para nxerrjes së Vendimeve me rëndësi për pozitën materiale ekonomike dhe sociale të punëtorëve dhe në bazë të tyre të orientohet,
- që sindikata të informohet mbi çështjet me rëndësi të veçantë për pozitën materiale dhe sociale të punëtorëve,
- Që sindikatës t'i dërgohen ftesat me materiale për arësye të pjesëmarrjes në mbledhjet në të cilat do të shqyrtohen idetë, propozimet, iniciativat dhe kërkesat e saja, gjegjësisht në të cilat vendoset mbi të drejtat e veçanta të punëtorëve.

Neni 41

Drejtori i Bibliotekës siguron kushte për punë dhe veprimet e sindikatës të përcaktuara me kontratën kolektive.

Aktivitetet e sindikatës kryhen në mënyrë që të mos shkojnë në dëm të realizimit të programit të punës dhe diciplinës në punë.

FSHEHTËSIA E PUNËS

Neni 42

Në interes të ruajtjes së sigurisë dhe mbrojtjes dhe kryerjes së suksesshme të veprimtarisë, disa shënime paraqesin fshehtësinë e punës dhe mund t'i tregohen personit të tretë vetëm në mënyrë të paraparë me Ligj, me këtë statut ose me urdhër të drejtorit.

Neni 43

Përveç shënimeve të cilat janë të shpallura me Ligj si fshehtësi e punës, dokumentet e tjera të bibliotekës që konsiderohen si fshehtësi në punë janë:

- dokumentet të cilat organi kompetent i shpallë si fshehtësi të punës,
- shënimet të cilat drejtori si të besueshme ia paraqet të punësuarve në Bibliotekë,
- shënimet me rëndësi të veçantë shoqërore, ekonomike ose kulturore,
- shënimet që përmbajnë ofertat për konkurs ose ofrim publik deri në shpalljen e konkursit,
- punët e mbrojtjes dhe sigurisë civile janë të shënuara si të besueshme.

Neni 44

Dokumentet dhe shënimet që nënkuptohen si fshehtësi e punës, organet dhe personat që janë përgjegjës për ruajtjen dhe publikimin e fshehtësisë së punës dhe të gjitha çështjet tjera lidhur me fshehtësinë e punës, më për së afërmi rregullohen më Vendim të veçantë.

MBROJTJA E MJEDISIT JETËSOR DHE HAPËSIRAVE TË PUNËS

Neni 45

Ndërmarrja e masave për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe hapësirave të punës janë pjesë përbërse e aktiviteteve të përgjithshme të të punësuarve dhe organeve në Bibliotekë.

Neni 46

Masat e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe hapësirave të punës përfshijnë zbatimin e zgjidhjes bashkëkohore teknike-teknologjike që sigurojnë pengimin, gjegjësisht mënjanimin e ndotjes së mjedisit jetësor dhe hapësirave të punës, avansimin e organizimit të punës dhe mënjanimin e shkaqeve që sjellin deri te vështërsitë e kushteve të punës dhe ndërmarrjen e masave për arsye të ofrimit të ndihmës organeve dhe organizatave tjera të cilat merren me këto çështje.

STATUTI DHE AKTET TJERA TË PËRGJITHSHME

Neni 47

Me Statut dhe me aktet tjera të përgjithshme rregullohen në mënyrë të përgjithshme raportet në Bibliotekë.

Me Kontratë kolektive, apo rregulloren e punës, gjegjësisht me Ligj rregullohen marrëdhëniet e punës të punëtorëve në Bibliotekë.

Neni 48

Këshilli drejtues i Bibliotekës nxjerr Statutin dhe aktet tjera të përgjithshme me të cilat rregullohen çështjet bazë në veprimtarinë dhe punën e Bibliotekës.

Themeluesi jep pëlqim në Statutin e Bibliotekës.

Neni 49

Drejtori i Bibliotekës parasheh organizimin e punës, sistematizimin, dhe çështjet tjera për të cilat është i obliguar me Ligj.

Neni 50

Aktet e përgjithshme shpallen në tabelën e shpalljeve publike të Bibliotekës.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 51

Me hyrjen në fuqi të këtij statuti pushon të vlejë Statuti i Bibliotekës „Mehmet Jusufi“ në Preshevë me Nr.45. të datës 01.12.2010.

Neni 52

Statuti nënkuptohet i miratuar në ditën e dhënies së pëlqimit nga ana e Kuvendit komunal të Preshevës.

Ky Statut pas marjes së pëlqimit nga themeluesi hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në tabelën e shpalljeve të Bibliotekës.

**Kryetari i Këshillit Drejtues
Reshat Abdyli**

70

a osnovu 15. 2.
(„
“, 26/2008)
16.04.2015, ,

Në mbështetje të nenit 15. Paragrafi 2. të Statutit të Komunës së Preshevës (“Fl. zyrtare e Rrethit të Pçinjës, numër 26/2008) Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me datë 16.04.2015 nxjerr këtë:

”

” AKTVENDIM

PËR DHËNIN E PËLQIMIT NË STATUTIN E SHTËPISË SË KULTURËS “ ABDULLA KRASHNICA “ PESHEVË

I.

„ “ ,
„ .35/2015 05.03.2015 .

Jepet pëlqimi në Statutin e Shtëpisë së kulturës “Abdulla Krashnica” Preshevë, të cilën e ka sjellur Këshilli drejtues i shtëpisë së Kulturës “ A. Krashnica “ me nr.35/2015 të datës 05.03.2015

II.

„ “
Statuti i shtëpisë së kulturës “Abdulla Krashnica” Preshevë do të jetë pjesë përbërëse e këtij Aktvednimi.

III. 3.

Ky aktvendim të shpallet në “Gazetën zyrtare e komunës së Bujanocit”

KUVENDI I KOMUNËS PRESHEVË

**I , Nr. 110-24
, 20.04.2015**

P r e s h e v ë

**, Kryetar,
.Dr. Ramiz Latifi**

71 II.

44. 1. 1. 5.
(„ . 72/09),
17. 1. “
55/14), 1. 1. 1. “ . 72/09
818/93.
: 07221738

6.
.118/2012), („ . 01
.65-1/92 30.12.1992,
” 30.01.2015 :

I. III.

1. 7.
“
”
“
(:) 8.
30.12.1992 . “15 “, .90.
01 .65-1 30.12.1992 .
2. 9.
().
3 : “
()
7 x 3

_____, ____20, ” “ VI.

10. 15.

.11

16.

IV.

12.

.1. 12.

17.

V.

13.

- 22110

- 22120

- 22210

- 55300

- 55400

- 80103

- 80420

- 92130

- 92310

- 92320

- 92340

- 92400

- 92511

- 92522

- 92610

- 92622

18.

14.

19.

20.

13.

24.

21.

VII.

22.

- 1.
- 2.
- 3.

1.

23.

4 ()

5()

2()

, 1 ()

2 ()

25.

26.

15 ,

2.

31.

27.

() , 1 ()

4 () ,

3

2 ()

28.

- :
- ;
- ,

32.

3.

29.

30.

() ()

4

60

30

33.

() ,

VIII.

34.

39.

IX.

35.

40.

36.

41.

XI.

XII.

37.

42.

X.

38.

43.

**S T A T U T I N
E SH TËPISË SË KULTURËS " ABDULLA
KRASHNICA " NË PRESHEVË**

I. DISPOZITAT THEMELORE

44

Neni 1.

Me këtë Statut rregullohen çështjet me rëndësi për funksionimin dhe kryerjen e veprimtarisë të këtij institucioni në sferën e kulturës, pozita juridike, organizimi i mbrendshëm, menaxhimi dhe çështjet tjera me rëndësi për këtë institucion.

45.

Shtëpia e Kulturës „ Abdulla Krashnica “ në Preshevë (në tekstin vijues : Shtëpia e Kulturës) si institucion kulturor është organizuar më datë 30.12.1992 vit.

XIII.

46.

Kuvendi Komunal i Preshevës realizon të drejtat dhe detyrat e themeluesit të Shtëpisë së Kulturës në bazë të vendimit 01 br.65-1/92 v, mbi organizimin e Univerzitetit të punëtorëve në Shtëpi të Kulturës.

47.

Neni 2.

Shtëpia e Kulturës është i nstitution kulturor e cila kujdeset për plotësimin e nevojave të qytetarëve si dhe në ruajtjen e realizimin e të drejtave të parapara me ligj në sferën e kulturës.

8 () ,

48.

Veprimtaria e Shtëpisë së Kulturës është publike.

Neni 3.

Me punët dhe detyrat e Shtëpisë së Kulturës udhëheq organi i saj i paraparë me ligj.

„ 14.02.2011 .

. 31/11

Të punësuarit në Shtëpinë e Kulturës realizojnë të drejtat dhe detyrat e tyre në mbështetje të Ligjit , Kontratës kolektive dhe dispozitave të këtij Statuti.

, 30.01.2015 .

q

Punëtorët kanë të drejtë të organizojnë Sindikatën që mbron të drejtat dhe interesat e punëtorëve të paraparë me Ligj dhe Kontratë kolektive.

71

Në bazë të nenit 44. paragrafi 1 pika1.të Ligjit mbi kulturën („Fl.zyrtare e RS“, nr.72/09), nenit 17. paragrafi 1. të Ligjit mbi Këshillat nacionale të pakicave nacionale („Fl.zyrtare e RS,, nr.72/09 dhe 55/14), Neni 1. paragrafi 1. pika 1. të Vendimit të Këshillit nacional të pakicës nacionale shqiptare për përcaktimin e institucioneve publike me rëndësi të veçantë për ruajtjen e identitetit kulturor kombëtar, përparimin dhe zhvillimin e veçorive të bashkësisë nacionale shqiptare, („Fl.zyrtare e RS“ nr.118/12), Vendimit mbi themelimin e Shtëpisë së Kulturës “Abdulla Krashnica“ nr. 01 br. 65 - 1/92 v. të datës 30.12.1992, Këshilli Drejtues i Shtëpisë së Kulturës „Abdulla Krashnica“ në Preshevë, në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2015 v, harmonizon:

Neni 4.

Shtëpia e Kulturës realizon veprimtarinë e vet në selinë e vet , por të njejtën sipas kërkesës së themeluesit mundë ta realizojë edhe në më shumë vende.

II. POZITA JURIDIKE

Neni 5.

Shtëpia e Kulturës është person juridik e cila kryen veprimtarinë e vet në sferën e kulturës.

Shtëpia e Kulturës është e regjistruar në regjistrin gjyqësor të Gjyqit ekonomik në Leskoc me numër 818/93.

Numri amë i Shtëpisë së Kulturës është : 07221738

Neni 6.

Shtëpia e Kulturës ka xhirollogarinë e vetë , por mundë të ketë edhe llogari të mjeteve me dedikim të veçantë në Shërbimin e Trezorit.

Në qarkullimin pagesor me personat e tretë Shtëpia e Kulturës paraqitet në emrin e vetë dhe për llogari të vetë.

Për obligimet e Shtëpisë së Kulturës themeluesi përgjigjet në mënyrë të pakufizuar dhe solide.

III. FIRMA DHE SELIA

Neni 7.

Emërtimi i Shtëpisë së Kulturës është : Shtëpia e Kulturës „ Abdulla Krashnica “ në Preshevë .

Shtëpia e Kulturës mund të ndryshojë emërtimin e saj vetëm me marrjen e pëlqimit nga themeluesi.

Neni 8.

Selia e Shtëpisë së Kulturës është në Preshevë, në rrugën „15 Nëntori “ nr. 90. Selia e Shtëpisë së Kulturës nuk mund të ndërrohet pa pëlqimin e themeluesit.

Neni 9.

Shtëpia e Kulturës ka vulën e rrumbullakët dhe vulën katërkëndëshe.

Vula e rrumbullakët e Shtëpisë së Kulturës ka diametër 3 cm në të cilën në qark (rreth) është i shkruar teksti : Republika e Sërbisë, Shtëpia e Kulturës „ Abdulla Krashnica “ , Preshevë.

Vula katërkëndëshe e Shtëpisë së kulturës ka formë këndëdrejtë me madhësi 7 x 3 cm ku është i shkruar teksti :

Republika e Sërbisë , Shtëpia e Kulturës „ Abdulla Krashnica“ nr.____,____20____, Preshevë.

Neni 10.

Teksti i vulës së rrumbullakët dhe vulës katërkëndëshe është i shkruar në gjuhën dhe shkrimin cirilik sërb dhe në gjuhën dhe shkrimin shqip.

Neni 11.

Mënyra e përdorimit dhe ruajtjes së vulës së rrumbullakët dhe katërkëndëshe rregullohet me udhëzim të veçantë të drejtorit të Shtëpisë së Kulturës.

IV. PËRFAQËSIMI DHE PREZENTIMI

Neni 12.

Shtëpinë e Kulturës e përfaqëson, prezenton dhe për të nënshkruan drejtori i Shtëpisë së Kulturës.

Në mungesë të drejtorit detyrat nga neni 12. mund ti kryej personi të cilin e autorizon

drejtori dhe ate plotësisht , ose vetëm në kryerjen e punëve të caktuara.

V. VEPRIMTARIA

Neni 13.

Shtëpia e Kulturës kryen këto veprimtari:

- **22110** Botimin e librave, broshurave, librave muzikore si dhe publikimeve tjera ;
- **22120** Botimin e gazetave;
- **22210** Shtypjen e gazetave ;
- **55300** Restoraneve ;
- **55400** Bareve ;
- **80103** Arsimimit fillorë të tipit të veçantë ;
- **80420** Arsimimit të të rriturve dhe arsimit tjetër në vendin tjetër jo të plotë ;
- **92130** Shfaqjen e filmave ;
- **92310** Krijimtaria artistike e letrare dhe arti skenik ;
- **92320** Puna e institucioneve artistike ;
- **92340** Aktivitetet tjera zbavitëse , në vendet tjera ë papërmëndura ;
- **92400** Veprimtaria e agjencioneve gazetareske ;
- **92511** Veprimtaria e bibliotekës ;
- **92522** Ruajtja e të mirave kulturore, natyrore dhe llojlojshmërive tjera ;
- **92610** Aktivitete sportive:punët nëpër objekte sportive të hapura dhe të mbyllura – stadiumeve të futbollit ;
- **92622** Aktivitete tjera sportive: garat tjera sportive profesionale dhe amatore në hapsirat e hapura apo të mbyllura.

Neni 14.

Shtëpia e Kulturës mund të zgjerojë apo të zvoglojë veprimtaritë e veta vetëm me pëlqimin paraprak të themeluesit.

VI. PLANIFIKIMI DHE MJETET

Neni 15.

Planet dhe programet e punës , Shtëpia e Kulturës i harton në pajtim me qëllimet për të cilat është themeluar ky institucion , detyrave të parapara me ligj , kërkesave të Kuvendit Komunal , nevojave të shfrytëzuesve dhe zhvillimit ekonomik, kulturor dhe shoqëror të komunës .

Neni 16.

Shtëpia e Kulturës harton planin dhe programin e punës për një vit kalendarik .

Në përputhshmëri me planin dhe programin vjetor, sipas nevojës hartohen edhe plane operative, me të cilët më për së afërmi përcaktohen detyrat nga programi i punës , precizohen afatet e realizimit të detyrave dhe qëllimeve të programit vjetor të punës , mënyra e realizimit si dhe personat përgjegjës për zbatimin e tyre.

Neni 17.

Planin dhe programin vjetor të punës të Shtëpisë së Kulturës , në propozim të drejtorit e bjen Këshilli Drejtues në afatin e paraparë me ligj.

Para se të aprovohet programi i punës , kërkohet mendimi i themeluesit , institucioneve arsimore si dhe organizatave tjera.

Për realizimin e planit dhe programit të punës përgjegjës është drejtori i Shëpisë së Kulturës.

Këshilli Drejtues shqyrton realizimin e planit dhe programit të punës si dhe merr masat e nevojshme për zbatimin e tyre në bazë të raportit të drejtorit të Shtëpisë së Kulturës.

Neni 18.

Programi vjetor përcakton përbërjen që del nga ligji i funksioneve të përcaktuara në institucionet kulturore , e në veçanti tregohet në :

- Llojin , vëllimin, përbërjen , mënyrën dhe kohën e realizimit të punëve dhe detyrave;
- Aktivitetet programore të cilat do të realizohen në bashkëpunim të ndërsjellë me institucionet tjera , si dhe programet tjera të veçanta (ekspozitave , takimeve letrare, manifestimeve dhe programeve të ndryshme kulturore-artistike etj);
- Numrin e përgjithshëm të punëtorëve dhe struktura e tyre për realizimin e programit të punës;
- Kushtet materjale, teknike, hapsinore dhe organizative për realizimin e programit të miratuar të punës si dhe kushtet për ngritjen e cilësisë dhe efikasitetit në punë ;
- Mjetet e nevojshme për realizimin e programit të punës dhe aktiviteteve.

Neni 19.

Mjetet për punë të Shtëpisë së Kulturës sigurohen nga themeluesi , drejtpërdrejtë nga shfrytëzuesit e shërbimeve dhe nga shitja e prodhimeve dhe shërbimeve në treg , si dhe nga donatorët dhe burimet tjera të parapara me ligj.

Neni 20.

Themeluesi siguron mjetet e nevojshme për realizimin e veprimtarive të parapara në nenin 13. të këtij Statuti.

Neni 21.

Kuvendi Komunal i siguron mjetet financiare për financimin ose bashkëfinancimin e programeve dhe projekteve kulturore si dhe hulumtimin e formave profesionale artistike nga veprimtaritë e caktuara kulturore , vendos cilat programe , gjegjësisht pjesë të programeve do të financohen nga mjetet buxhetore dhe njëherit përcakton shumën e këtyre mjeteve.

Shtëpia e Kulturës si shfrytëzues i mjeteve buxhetore është e obliguar që themeluesit ti japë raport rreth realizimit të programit të punës dhe shfrytëzimit të mjeteve.

VII. ORGANET E SHTËPISË SË KULTURËS

Neni 22.

Organet e Shtëpisë së Kulturës janë :

- 1.Këshilli Drejtues ,
- 2.Këshilli Mbikqyrës dhe
- 3.Drejtori

1.KËSHILLI DREJTUES

Neni 23.

Këshilli Drejtues është organ udhëheqës i Shtëpisë së Kulturës .

Këshillin Drejtues të Shtëpisë së Kulturës e emëron dhe e shkarkon themeluesi.

Këshilli Drejtues i Shtëpisë së Kulturës zgjidhet me mandat 4(katër) vjeçar, me të drejtë rizgjedhje më së shumti dy herë,

Këshilli Drejtues i Shtëpisë së Kulturës ka 5 (pesë) anëtarë nga të cilët 2 (dy) anëtarë i cakton themeluesi , 1 (nji) anëtarë e cakton Këshilli nacional i pakicës nacionale shqiptare dhe 2 (dy) anëtarë caktohen nga përbërja e punëtorëve të Shtëpisë së Kulturës, në pajtim me ligjin,

Në listën e caktuar të anëtarëve të Këshillit Drejtues nga radhët e themeluesit dhe të institucionit jep mendim Këshilli nacional i pakicës nacionale shqiptare ,

Afati i dhënjes së mendimit për anëtarët e propozuar të Këshillit Drejtues nga Këshilli nacional i pakicës nacionale shqiptare është 15 ditë, nëse mendimi nuk jepet mbrenda këtij afati atëherë konsiderohet se mendimi është dhënë,

Në rast të dorëheqjes apo shkarkimit të ndonjërit nga anëtarët e Këshillit Drejtues , procedura e emërimit të anëtarit të ri është e njëjtë sikur se me rastin e emërimit të Këshillit Drejtues të institucionit, mandati i anëtarit të ri skadon me përfundimin e mandatit të Këshillit Drejtues të emëruar,

Kryetarin e Këshillit Drejtues të Shtëpisë së Kulturës e emëron dhe e shkarkon themeluesi.

Neni 24.

Këshilli Drejtues i Shtëpisë së Kulturës kryen këto punë :

- Nxjerr Statutin e Shtëpisë së Kulturës ,
- Nxjerr akte tjera të përgjithshme të Shtëpisë së Kulturës të parapara me ligj dhe statut ,
- Vendos mbi punën e Shtëpisë së Kulturës ,
- Nxjerr programin e punës të Shtëpisë së Kulturës , në propozim të drejtorit ,
- Nxjerr planin financiar vjetor,

- Miraton raportin e punës, raportin e financiar dhe llogarinë përfundimtare,
- Jep propozimin për ndryshimet statutare , në pajtim me ligjin,
- Shpallë konkursin për drejtor dhe i jep themeluesit propozimin e kandidatit për drejtor ,në pajtim me ligjin ,
- Lidhë kontratë të punës me drejtorin , në kohë të caktuar, deri në skadimin e afatit në të cilën është zgjedhë gjejtësisht deri në shkarkimin e tij ,e në rast se për drejtor emërohet personi i cili është i punësuar në instutucion në kohë të pacaktuar , atëherë lidhë aneks kontratë të punës, në pajtim me ligjin,
